



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION

Prishtinë
06.03.2026

Nr.: 93/2026

KËSHILLI DREJTUES I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të dispozitave përkatëse të nenit 46 të Ligjit për Avokatinë dhe nenit 61 të Statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës për pagesën e anëtarësisë vjetore për vitin 2026, në mbledhjen e mbajtur më 06.03.2026, merr këtë:

V E N D I M

I. CAKTOHET data 31 mars 2026 si afat përfundimtar dhe i detyrueshëm për pagesën e anëtarësisë për vitin 2026 për të gjithë avokatët e regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës.

II. OBLIGOHET administrata e Odës së Avokatëve të Kosovës që, pa vonesë, të njoftojë individualisht të gjithë avokatët që nuk e kanë kryer pagesën e anëtarësisë për vitin 2026, duke u dërguar njëkohësisht edhe faturën përkatëse.

III. Në njoftimin nga pika II, avokatët **PARALAJMËROHEN** shprehimisht se, në rast të moskryerjes së pagesës deri më 31 mars 2026, ndaj tyre do të ndërmerren masa për çregjistrim nga lista e avokatëve, në përputhje me aktet normative në fuqi të Odës së Avokatëve të Kosovës.

IV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi, për të gjithë avokatët që nuk e kanë përmbushur detyrimin e pagesës dhe nuk kanë status të rregulluar (pagesë apo pezullim), pasojat juridike lindin dhe zbatohen në mënyrë automatike, në përputhje me aktet normative në fuqi, ndërsa çregjistrimi nga lista e avokatëve realizohet ex officio nga administrata, pa nevojën e nxjerrjes së një vendimi të veçantë nga Këshilli Drejtues.

V. Për avokatët që paraqesin kërkesë të arsyetuar për pezullim të anëtarësisë, të mbështetur me dokumentacion përkatës, do të zbatohen dispozitat përkatëse të akteve normative të Odës.

Arsyetim

Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës, duke ushtruar kompetencat e tij statutare dhe rregullatore, ka shqyrtuar çështjen e përmbushjes së detyrimit për pagesën e anëtarësisë për vitin 2026 dhe, në bazë të gjendjes faktike të krijuar, ka vlerësuar të nevojshme ndërmarrjen e masave të përcaktuara në dispozitiv të këtij vendimi.



Nga të dhënat e administratës së Odës rezulton se, para përfundimit të vitit 2025, janë përgatitur dhe shpërndarë faturat për pagesën e anëtarësisë për secilin avokat, përmes postës elektronike, me ç'rast pranimi i tyre është konfirmuar nga ana e avokatëve përkatës. Me këtë, Oda ka përmbushur detyrimin për njoftim të rregullt dhe në kohë lidhur me obligimin financiar të anëtarësisë.

Afati për kryerjen vullnetare të pagesës është caktuar deri më 31 janar 2026, ndërsa para skadimit të këtij afati, më datë 27 janar 2026, është dërguar rikujtim shtesë për avokatët që nuk e kishin përmbushur ende këtë detyrim. Edhe pas kalimit të këtij afati, administrata e Odës ka vazhduar me njoftime dhe rikujtime të njëpasnjëshme, duke i informuar avokatët për detyrimin e tyre dhe për pasojat që rrjedhin nga moskryerja e pagesës.

Pavarësisht këtyre veprimeve dhe mundësive të arsyeshme të dhëna, një numër i avokatëve nuk e kanë përmbushur detyrimin për pagesën e anëtarësisë.

Në këto rrethana, Këshilli Drejtues ka vlerësuar se është e nevojshme të caktohet një afat përfundimtar shtesë, i cili njëkohësisht përfaqëson edhe mundësinë e fundit për përmbushjen e detyrimit. Caktimi i datës 31 mars 2026 si afat i fundit është bërë duke pasur parasysh:

- kohën e mjaftueshme që u është dhënë avokatëve që nga shpërndarja fillestare e faturave;
- rikujtimet e vazhdueshme të dërguara nga Oda;
- nevojën për të vendosur një kufi të qartë kohor për përmbushjen e detyrimeve;
- si dhe sigurimin e funksionimit të rregullt financiar dhe institucional të Odës.

Po ashtu, Këshilli Drejtues ka vlerësuar se është e domosdoshme që administrata të obligohet për njoftim individual të avokatëve që nuk e kanë kryer pagesën, me qëllim që:

- të eliminohet çdo paqartësi eventuale lidhur me detyrimin dhe afatin;
- të garantohet transparencë dhe siguri juridike;
- dhe t'u jepet mundësi reale dhe e fundit për përmbushjen e detyrimit para ndërmarrjes së masave.

Ky veprim nuk përbën një njoftim të ri për detyrimin, por një konfirmim përfundimtar dhe paralajmërim të qartë për pasojat juridike që rrjedhin nga moskryerja e pagesës.

Këshilli Drejtues vlerëson se pagesa e anëtarësisë është detyrim thelbësor që buron nga statusi i anëtarit dhe lidhet drejtpërdrejt me funksionimin e Odës dhe barazinë ndërmjet avokatëve. Mosrespektimi i këtij detyrimi, përkundër njoftimeve dhe afateve të dhëna, nuk mund të tolerohet pa pasoja, pasi cenon funksionimin institucional dhe parimin e përgjegjësisë së barabartë.

Për këtë arsye, pas përfundimit të afatit të fundit të caktuar, do të zbatohen dispozitat përkatëse statutare dhe ligjore që rregullojnë pasojat e moskryerjes së pagesës, në përputhje me aktet normative në fuqi të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Në përfundim, Këshilli Drejtues vlerëson se vendimi për caktimin e afatit deri më 31 mars 2026, obligimi për njoftim të avokatëve që nuk kanë kryer pagesën dhe paralajmërimi për pasojat përkatëse përbëjnë masa të arsyeshme, proporcionale dhe të domosdoshme për sigurimin e respektimit të detyrimeve të anëtarësisë dhe funksionimit të rregullt të Odës.

Për këto arsye, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLI DREJTUES I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS
Nr. 93/26, datë 06.03.2026

Besnik R. BERISHA
Kryetar i OAK-së

